




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2166/14, për **z. Nuhi Krasniqi**, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe pronës në Komunën e Malishevës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Nuhi Krasniqi – Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe pronës si dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Krasniqi është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pas analizimit të gjendjes është konstatuar se z. Krasniqi nuk ushtron më funksion publik, kjo është vërtetuar edhe në formularët e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, zyrtari i lartë pas përfundimit të funksionit publik, mund të ushtrojë funksion menagjues në biznes privat, prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

